KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e V-të në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

7 maj 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 04 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha se "deri më tani janë regjistruar mbi 1 milion e 200 mijë persona. Jemi duke iu afruar fundit të Regjistrimi të Popullsisë dhe nuk kemi probleme profesionale. Stafi në terren është duke funksionuar, ashtu edhe pajisjet.

Të gjitha komunat janë duke marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë, gjithashtu edhe në Veri, megjithëse ka një hezitim në një pjesë të kësaj popullsie.

Regjstrimi i Popullsisë është duke u monitoruar në kohë reale, pra gjatë ditës së njëjtë të grumbullimit të të dhënave, si nga burimet e jashtme dhe aq më shumë nga të dhënat prej Regjistrimit të kaluar të Popullsisë.